




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac – Municipality of Rahovec

KRYETARI I KOMUNËS
Presednik Opštine – Municipal Mayor

LISTA E VENDIMEVE TË MARRA NGA KRYETARI I KOMUNËS SË RAHOVECIT,
Z. SMAJL LATIFI

NGA DATA 01.05.2025 DERI MË 09.05.2025

NR.	EMRI I VENDIMIT	NR. I PROTOKOLLIT
1.	Vendim për emërimin e Drejtorit të SHML “12 Maji” në Ratkoc.	NRP-02-5721-2025
2.	Vendim për ndërimin (kolaodimin) e pozicioneve në kontratën me titull “Ndërtimi dhe rregullimi i Shtëpisë Muze” Bajram Curri” në Krushën të Madhe”.	NRP-02-5723-2025
3.	Vendim për formimin e komisionit të rekrutimit për zhvillimin e procedurës së pranimit në punë të një Zyrtari për kthim të Qendrueshëm në Zyren Komunale për Komunitete dhe Kthim në Komunën e Rahovecit.	NRP-02-5725-2025
4.	Vendim për formimin e komisionit për zhvillimin e procedurës së pranimit të një Avokati Komunal në Zyrën Ligjore, të Zyra e Kryetarit të Komunës së Rahovecit.	NRP-02-5726-2025
5.	Vendim për përfundimin e marrëdhënjes së punës.	NRP-02-5728-2025
6.	Vendim për formimin e komisionit të rekrutimit për zhvillimin e procedurës së pranimit në punë të një Zyrtari për Sport në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport.	NRP-02-5729-2025
7.	Vendim për obligimin e përfshirjes në listen e pagës me pagë të plotë mujore.	NRP-02-5732-2025
8.	Vendim për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave.	NRP-02-5737-2025
9.	Vendim për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave.	NRP-02-5738-2025
10.	Vendim për themelimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijëve.	NRP-02-5741-2025
11.	Vendim për miratimin e kërkesës për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).	NRP-02-5745-2025
12.	Vendim për miratimin e kërkesës për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).	NRP-02-5746-2025

13.	Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave.	NRP-02-5750-2025
14.	Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave.	NRP-02-5751-2025
15.	Vendim për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike/termave të referencës për aktivitetin e prokurimit: "Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve"	NRP-02-5752-2025
16.	Vendim për miratimin e kërkesës për ndihmë financiare (mbulimi i shpenzimeve të mjekimit dhe blerjen e barnave).	NRP-02-5752-2025
17.	Vendim për miratimin e kërkesës për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).	NRP-02-5758-2025
18.	Vendim për caktimin e menaxherit dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës: "Furnizimi me rekuizita për nevojat e Komunës së Rahovecit"	NRP-02-5759-2025
19.	Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për caktimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave për nënpunësit e shërbimit publik.	NRP-02-5763-2025



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 5721 Nr. i faq./Br.str./No.pg 75
Data/Datum/Date 02 / 05 / 25
RAHOVEC / ORAHOVAC

Duke u mbështetur në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 mbi Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 79 paragrafi 2 i Ligjit Nr. 08/L-197 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 21/2023"), nenit 35 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 17/2011"), nenit 5 shkronja (d) të Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës dhe nenit 15 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr. 19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunorëve Profesional, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, Vendimit të Komisionit për përgjedhjen e drejtorit dhe zëvendësdrejtorit të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësues profesional me Nr. Prot. 04/587 të datës 28.04.2025, Kryetari i Komunës së Rahovecit në cilësinë e Udhëheqësit më të Lartë Administrativ, merr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e Drejtorit të SHML "12 Maji" në Ratkoc

1. Xhevdet Hoti nga fsh. Ratkoc, Komuna e Rahovecit, **EMËROHET** Drejtor në SHML "12 Maji" në Ratkoc, duke filluar punën nga data 12.5.2025.
2. Marrëdhënia e punës themelohet për periudhën kohore me kontratë 4 (katër) vjeçare.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Arsim dhe Zyra e Personelit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Pas zhvillimit të të gjitha procedurave të rekrutimit nga ana e komisionit për përgjedhjen e drejtorit/es dhe zëvendësdrejtorit/eshës së Institucioneve Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese Parauniversitare (IEAAP) i caktuar me Vendim të Kuvendit të Komunës me Nr. Prot. 01 Nr. 219/24 i datës 29.04.2024, duke u bazuar në rezultatet e vlerësimit të përgjithshëm të kandidatëve të cilët kanë aplikuar në konkursin e shpallur nga Drejtoria për Arsim me Nr. Prot. 04/445 të datës 18.02.2025, komisioni përzhgjedhës me datë 28.04.2025, duke u bazuar në pikët e fituara në procedurë të rekrutimit ka përgjedhur me vendim kandidatin më të sukseshëm Xhevdet Hoti nga fsh. Ratkoc.

Andaj duke u bazuar në rekomandimin e Komisionit përzhgjedhës si dhe duke u bazuar në nenit 15 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr. 19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve

dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunorëve Profesional, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar Xhevdet Hoti nga fsh. Ratkoc emërohet Drejtor në SHML “12 Maji” në Ratkoc, duke filluar punën nga data 12.5.2025 me periudhë të caktuar 4 (katër) vjeçare.

Andaj, nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese pranë Komisionit për shqyrtimin e ankesave për nëpunësit e shërbimit publik në Komunën e Rahovecit, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të tij.

Vendimi u dërgohet:

- *Xhevdet Hoti nga fsh. Ratkoc,*
- *Drejtorisë për Arsim,*
- *Zyrës së Personelit, dhe*
- *Arkivit.*


Smajl Latifi
Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 5723 Nr. i faq/Br.str/No.pg 75

Data/Datum/Date 02 / 05 / 25

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), dispozitave të Ligjit 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 18/2011”), dispozitave të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kontratës me titull “Ndërtimi dhe rregullimi i Shtëpisë Muze “Bajram Curri” në Krushë të Madhe” me Nr. të Prokurimit 623-23-9479-5-2-1 dhe Nr. të brendshëm 623-23-059-5-2-1, kërkesës dhe rekomandimit të Menaxherit të kontratës me Nr. Prot. 1227 të datës 16.04.2025, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për ndërrimin (kolaodimin) e pozicioneve në kontratën me titull “Ndërtimi dhe rregullimi i Shtëpisë Muze “Bajram Curri” në Krushë të Madhe”

1. Me këtë vendim **lejohet** ndërrimi (kolaodimi) i pozicioneve të situacionit nga një pozicion në tjetrin, në kontratën me titull “Ndërtimi dhe rregullimi i Shtëpisë Muze “Bajram Curri” në Krushë të Madhe” me Nr. të Prokurimit 623-23-9479-5-2-1 dhe Nr. të brendshëm 623-23-059-5-2-1.
2. Ndërrimi (kolaodimi) i pozicioneve sipas pikës 1 të këtij vendimi do të bëhet nga pozicioni i kontratës: Pos.10.4, në pozicionin e domosdoshëm për realizim: Pos.10.4.1, pa implikime financiare shtesë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Zyra e Prokurimit, Menaxheri i Kontratës dhe Mbikëqyrësi i Drejtëpërdrejtë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Ofruesi i shërbimeve (punëkryesi) i kontratës me titull “Ndërtimi dhe rregullimi i Shtëpisë Muze “Bajram Curri” në Krushë të Madhe” me Nr. të Prokurimit 623-23-9479-5-2-1 dhe Nr. të brendshëm 623-23-059-5-2-1, i ka kërkuar dhe rekomanduar menaxherit të kontratës ndërrimin (kolaodimin) e pozicioneve në këtë kontratë, me qëllim të përfundimit të këtij projekti.

Pas kësaj, Menaxheri i Kontratës ka parashtruar kërkesën dhe rekomandimin me Nr. Prot. 1227 të datës 16.04.2025, me anë të së cilës ka kërkuar nga Zyrtaari Kryesor Administrativ ndërrimin (kolaodimin) e pozicioneve nga një pozicion në tjetrin, në kontratën me titull “Ndërtimi dhe rregullimi i Shtëpisë Muze “Bajram Curri” në Krushë të Madhe” me Nr. të Prokurimit 623-23-9479-5-2-1 dhe Nr. të brendshëm 623-23-059-5-2-1 dhe atë nga pozicioni i kontratës: Pos.10.4, në pozicionin e domosdoshëm për realizim: Pos.10.4.1, pa implikime financiare shtesë.

Ky ndërrim (kolaodim) i pozicioneve është bërë me qëllim të përfundimit të projektit, me të cilin është rënë dakord me Operatorin Ekonomik dhe me Menaxherin e Kontratës dhe Mbikëqyrësin e Drejtëpërdrejtë të Menaxherit të Kontratës që të bëhet pa implikime financiare.

Pas konsultimit me Sektorin e Prokurimit, Menaxherin e kontratës dhe Mbikëqyrësin e drejtëpërdrejtë, si dhe pas vlerësimit të fakteve në shkresat e lëndës, është vendosur për ndërrim të pozicioneve në kontratën e lartpërmendur.

Andaj, duke u bazuar në atë që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- ***Menaxheri i Kontratës,***
- ***Mbikëqyrësit të Drejtëpërdrejtë,***
- ***Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***




Smajl Latifi

Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna Rahovec
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës nr.05/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), nenit 40 të Ligjit Nr. 08L-197 për Zyrtarët Publikë, nenit 20 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 92 të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni i Rekrutimit për të zhvilluar procedurën e pranimin në punë të një Zyrtari për Kthim të Qëndrueshëm në Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim në Komunën e Rahovecit, sipas konkursit RN00017169, në këtë përbërje:
 1. Lendrit Qeli, kryesues,
 - 1.1. Ivana Mojsiq, zëvendësuese,
 2. Skender Hamza, anëtar,
 - 2.1. Fiknete Kasapi-Iska, zëvendësuese,
 3. Agron Thaqi, anëtar,
 - 3.1. Ilir Haxhijaha, zëvendësues,
 4. Njomeza Fazliu, anëtare,
 - 4.1. Valmir Gashi, zëvendësues,
 5. Habibe Haxhimustafa, anëtare,
 - 5.1. Alban Gashi, zëvendësues.
2. Detyrat e komisionit janë të përcaktuara me Ligjin Nr. 08L-197 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset komisioni.
4. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Komisioni,
- Udhëheqësi i Personelit, dhe
- Arkivi.




Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna Rahovec

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), nenit 40 të Ligjit Nr. 08L-197 për Zyrtarët Publikë, nenit 20 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 92 të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës Rahovec, merr këtë:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni i Rekrutimit për të zhvilluar procedurën e pranimin në punë të një Avokati Komunal në Zyrën Ligjore, te Zyra e Kryetarit të Komunës së Rahovecit, sipas konkursit RN00017160, në këtë përbërje:
 1. Isak Hoti, kryesues,
 - 1.1. Qëndresa Duraku, zëvendësuese,
 2. Skender Hamza, anëtar,
 - 2.1. Fiknete Kasapi-Iska, zëvendësuese,
 3. Agron Thaqi, anëtar,
 - 3.1. Ilir Haxhijaha, zëvendësues,
 4. Njomeza Fazliu, anëtare,
 - 4.1. Valmir Gashi, zëvendësues,
 5. Mirsad Shala, anëtar,
 - 5.1. Alban Gashi, zëvendësues.
2. Detyrat e komisionit janë të përcaktuara me Ligjin Nr. 08L-197 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset komisioni.
4. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Komisioni,
- Udhëheqësi i Personelit, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 5728 Nr. i faq/Br.str/No.pg 75

Data/Datum/Date 02 / 05 / 25

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës, Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), nenit 60, paragrafi 1, pika 3 e Ligjit për Zyrtarët Publikë Nr.08/L-197, si dhe nenit 92 të Statutit të komunës së Rahovecit, kryetari i Komunës, merr këtë:

**VENDIM
PËR PËRFUNDIMIN E MARRËDHËNIES SË PUNËS**

1. **MIFTAR KRASNIQI** nga Gexha, komuna e Rahovecit, në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe i sistemuar në punët dhe në detyrat e punës: Gjeometër për mirëmbajtjen e patundshmërive, në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, **I PËRFUNDON MARRËDHËNIA E PUNËS** nga data 11.5.2025.

2. **OBLIGOHET** Drejtoria për Buxhet dhe Financa që punëtorin ta largojë nga lista e pagave nga data 11.5.2025.

3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Punëtorit **MIFTAR KRASNIQI** nga Gexha, komuna e Rahovecit, në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe i sistemuar në punët dhe në detyrat e punës: Gjeometër për mirëmbajtjen e patundshmërive, në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, **I PËRFUNDON MARRËDHËNIA E PUNËS** nga data 11.5.2025.

Sipas detyrës zyrtare, Njësia e Personelit, ka konstatuar që punëtori i lartpërmendur, më datë 10.5.2025, arrin moshën e pensionimit, ngase i bën 65 vjet.

Prandaj, kryetari i Komunës, pas administrimit të provave dhe të fakteve, vërtetoi gjendjen faktike dhe vendosi që punëtorit **MIFTAR KRASNIQI**, nga data 11.5.2025, **I PËRFUNDON** marrëdhënia e punës për shkak të pensionimit.

Nga se u tha më lart, kryetari i Komunës, vendosi si në dispozitiv të vendimit.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi, punëtori ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes në dorëzim të vendimit, Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës.

Kopja e vendimit u dorëzohet:

1. Punëtorit,
2. Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,
3. Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,
4. Dosjes personale, dhe
5. Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna Rahovec



Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 5729 Nr. i faq./Br.str/No.pg 75

Data/Datum/Date 02 / 05 / 25

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), në nenin 40 të Ligjit Nr. 08L-197 për Zyrat e Publikë, nenit 20 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 92 të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës Rahovec, merr këtë:

V E N D I M

- Formohet komisioni i rekrutimit për të zhvilluar procedurën e pranimin në punë të një Zyrtari për Sport, në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, sipas konkursit me RN00017465, në këtë përbërje:
 - Qemajl Krasniqi, kryesues,
 - Faik Thaqi, zëvendësues,
 - Shedat Ukaj, anëtar,
 - Tefik Krasniqi, zëvendësues,
 - Agron Thaqi, anëtar,
 - Muharrem Morina, zëvendësues,
 - Njomëza Fazliu, anëtare,
 - Valmir Gashi, zëvendësues,
 - Arsim Kastrati, anëtar,
 - Alban Gashi, zëvendësues.
- Detyrat e komisionit janë të përcaktuara me Ligjin Nr. 08L-197 për Zyrat e Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.
- Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset komisioni.
- Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Komisioni,
- Udhëheqësi i Personelit, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 5732 Nr. i faq./Br.str/No.pg 76
Data/Datum/Date 05 / 05 / 25
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, si dhe nenit 92 të Statutit të Komunës, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **OBLIGOHET** Drejtoria për Buxhet dhe Financa, që znj. Hana Troshupa, e sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: Zyrtar për Shërbime Sociale, në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Rahovec, ta përfshijë në listën e pagave me pagë të plotë mujore nga data 19.4.2025.

2. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimit u dorëzohet:

- Hana Troshupës,
- Drejtorisë për Financa dhe Buxhet,
- Njësisë së Personelit, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECI / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No. 5738 Nr. i faq./Br.str./No.pg 76
Data/Datum/Date 05 / 05 / 25
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: “Ndërtimi i rrugës në Rahovec nga rrethrotullimi “Rija” deri në dalje të rrugës Xërxë – Ritenderim”, me Nr. prokurimi: 623-25-2742-5-1-1, dhe Nr. të brendshëm 623-25-029-5-1-1 të datës: 5.5.2025, në këtë përbërje:
 - 1.1. Sokol Thaqi, kryesues,
 - 1.2. Vjollca Berisha, anëtare,
 - 1.3. Egzon Thaqi, anëtar,
2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për projektin “Ndërtimi i rrugës në Rahovec nga rrethrotullimi “Rija” deri në dalje të rrugës Xërxë – Ritenderim”, me Nr. prokurimi: 623-25-2742-5-1-1, dhe Nr. të brendshëm 623-25-029-5-1-1 të datës: 5.5.2025.
3. Obligohet komisioni që këto punë ti kryej duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.
5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Zyrës së Prokurimit, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 5741 Nr. i faq./Br.str/No.pg 77

Data/Datum/Date 06 / 05 / 25

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 20 të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 14/2019"), nenit 8 të Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 06/2022 për themelimin dhe funksionimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijëve, nenit 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për themelimin e ekipit për të Drejtat e Fëmijëve

1. Me këtë vendim **themelohet** ekipi për të Drejtat e Fëmijëve, në Komunën e Rahovecit, në këtë përbërje:
 - 1.1. Smajl Latifi – kryetar i Komunës, kryesues i ekipit;
 - 1.2. Saranda Sallteku – drejtoreshë e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, zëvendëskryesues e ekipit;
 - 1.3. Avni Morina – drejtor i Drejtorisë për Arsim, anëtar;
 - 1.4. Shemsije Deliu - Drejtorja për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, anëtare;
 - 1.5. Qemajl Krasniqi – Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar;
 - 1.6. Ekrem Bytyqi – Drejtorja për Buxhet dhe Financa, anëtar;
 - 1.7. Defrim Kafexhiu – Përfaqësues i Komitetit për Politikë dhe Financa, anëtar;
 - 1.8. Bajram Morina – përfaqësues i Komitetit për Komunitete, anëtar;
 - 1.9. Habibe Haxhimustafa – Njësia për të Drejtat e Njeriut, anëtare;
 - 1.10. Qerim Hoti – përfaqësues i Policisë së Kosovës, anëtar;
 - 1.11. Hyrmete Topalli – Qendra për Punë Sociale, anëtare;
 - 1.12. Adelina Paqarizi – Përfaqësuese nga Shoqëria Civile, anëtare.
2. Në cilësinë e anëtarëve vëzhgues dhe të këshilltarëve të jashtëm janë:
 - 2.1. Ea Çanta – përfaqësuese e fëmijëve apo e grupit të fëmijëve, anëtare;
 - 2.2. Erseka Cana – kryetare e Këshillit të Prindërve, anëtare;
 - 2.3. Mark Kaçinari – përfaqësues nga Zyra e Rajonale e Institucionit të Avokatit të Popullit, anëtar;
 - 2.4. Vjollca Gurgule – përfaqësuese e Organizatës SHL Kosova, anëtare.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e ekipit për të Drejtat e Fëmijëve janë të përcaktuara në nenin 7 Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr. 06/2022 për themelimin dhe funksionimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijëve.
4. Për kryerjen e detyrave si në pikën 3 të këtij vendimi, ekipi punues raporton te ministria përgjegjëse për Qeverisje Lokale në baza gjashtë (6) - mujore.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e ekipit për të Drejtat e Fëmijëve.
6. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi me nr. prot. 02/366/2023, i datës 30.3.2023, i ndryshuar dhe i plotësuar me vendimin me nr. prot.02/5535/2025, i datës 4.4.2025.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendim u dërgohet:

- *Anëtarëve të ekipit,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – **Municipal Mayor**



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.4 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e **Florinde Oruqi Mushla** nga Rahoveci me Nr. Protokolit 06-553/01-0016655/25, e dt. 05.05.2025 për ndihmë financiare prej 500.00€ (pesëqind euro) për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Znj.Florinde Oruqi Mushla nga Rahoveci me datë 06.05.2025 ka parashtruar kërkesë për ndihmë financiare për lehoni (lindje) pasi që me datë 30.04.2025 ka lindur **Djal** në QKMF “Dr. Fahredin Hoti” në Rahovec.

Marrë parasysh se, e lartpërmendura nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme dhe me këtë rast e njëjta pas shpenzimeve të lindjes e ka të vështirë përballimin e shpenzimeve të blerjes së gjërave elementare për fëmijën, është e domosdoshme ndihma financiare për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë për **znj.Florinde Oruqi Mushla** si dhe ndihma për sigurimin e gjërave elementare për foshnjën.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

Me vendim të njoftohen:

- **Znj.Florinde Oruqi Mushla**, nga Rahoveci,
- **Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,**
- **Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe**
- **Arkivi.**





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 5746 Nr. i faq./Br.str./No.pg 77
Data/Datum/Date 06/05/25
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.4 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e **Laureta Ejupi** nga Rahoveci me Nr. Protokolit 06-553/01-0016929/25, e dt. 06.05.2025 për ndihmë financiare prej 500.00€ (pesëqind euro) për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Znj.Laureta Ejupi nga Rahoveci me datë 06.05.2025 ka parashtruar kërkesë për ndihmë financiare për lehonitë (lindje) pasi që me datë 13.04.2025 ka lindur **Vajzë** në QKMF "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec.

Marrë parasysh se, e lartpërmendura nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme dhe me këtë rast e njëjta pas shpenzimeve të lindjes e ka të vështirë përballimin e shpenzimeve të blerjes së gjërave elementare për fëmijën, është e domosdoshme ndihma financiare për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë për **znj.Laureta Ejupi** si dhe ndihma për sigurimin e gjërave elementare për foshnjën.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

Me vendim të njoftohen:

- **Znj.Laureta Ejupi**, nga Rahoveci,
- **Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale**,
- **Drejtoria për Buxhet dhe Financa**, dhe
- **Arkivi**.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA GRAHOVAČ / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 5750 Nr. i faq/Br.str/No.pg 77

Data/Datum/Date 07 / 05 / 25

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

1. Caktohet komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: **“Rregullimi i oborrit dhe riparime të brendshme në objektin e zjarrfikësve”**, me nr. prokurimi: 623-25-2996-5-2-1, dhe me nr. të brendshëm: 623-25-034-5-2-1, të datës 6.5.2025, në këtë përbërje:
 - 1.1. Egzon Thaqi, kryesues,
 - 1.2. Gërmia Gashi, anëtare,
 - 1.3. Faik Thaqi, anëtar.
2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për projektin “Rregullimi i oborrit dhe riparime të brendshme në objektin e zjarrfikësve”, me nr. prokurimi: 623-25-2996-5-2-1, dhe me nr. të brendshëm: 623-25-034-5-2-1, të datës 6.5.2025.
3. Obligohet komisioni që këto punë t’i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.
5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Zyrës së Prokurimit, dhe
- Arkivit.

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E ORAHOVAC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 5751 Nr. i faq./Br.str./No.pg 78
Data/Datum/Date 07 / 05 / 25
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

1. Caktohet komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: “**Ndërtimi i qendrës përkujtimore të UÇK-së në Retijë (ndërtimi i kullës)**”, me nr. prokurimi: **623-25-2976-5-2-1**, dhe me nr. të brendshëm: **623-25-017-5-2-1**, të datës 6.5.2025, në këtë përbërje:
 - 1.1. Jetmir Ukaj, kryesues,
 - 1.2. Vjollca Berisha, anëtare,
 - 1.3. Egzon Thaqi, anëtar.
2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për projektin “**Ndërtimi i qendrës përkujtimore të UÇK-së në Retijë (ndërtimi i kullës)**”, me nr. prokurimi: 623-25-2976-5-2-1 dhe me nr. të brendshëm 623-25-017-5-2-1, të datës 6.5.2025.
3. Obligohet komisioni që këto punë t’i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.
5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.


Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Zyrës së Prokurimit, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 28 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 18/2011”), nenit 19 paragrafi 19.16 i Rregullores Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës për aktivitetin e prokurimit: “Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve”

1. Samir Hasku, i sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: Përgjegjës për automjetet zyrtare , në Drejtorinë për Administratë të Përgjithshme, **emërohet** person përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës për aktivitetin e prokurimit: **“Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve”**.
2. Personi përgjegjës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, ka për detyrë që të bëjë hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës, duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik dhe Rregulloren Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.
3. Përgjegjësitë e personit për hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës, janë:
 - 3.1. Në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuar drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomikë, në përputhje me nenin 28 Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe akteve nënligjore (legjislacionit dytësor);
 - 3.2. Në atë mënyrë që nuk favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomikë;
 - 3.3. Të cilat nuk i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, një procesi të hollësishëm, ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë, ose ndonjë prodhimi.

4. Personi përgjegjës obligohet që të hartojë specifikimet teknike / termat e referencës deri më datë 12.5.2025.
5. Personi përgjegjës obligohet që, së bashku me specifikimet teknike / termat e referencës, të dorëzojë edhe deklaratën në betim, të nënshkruar te Njësia e Prokurimit.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- ***Samir Hasku,***
- ***Drejtoria për Administratë të Përgjithshme,***
- ***Njësia e Prokurimit, dhe***
- ***Arkivi.***





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET-PRESEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 5757 Nr. i faq./Br.str./No.pg 78
Data/Datum/Date 08 / 05 / 25
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.1 dhe 2.2 i Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr. 1427 të datës 28.4.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e Musa Cenës nga Rahoveci, me nr. prot. 1590, e datës 7.5.2025 për ndihmë financiare prej 900.00€ (nëntëqind euro) për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit dhe për blerjen e barnave për tretman të sëmundjes.
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Musa Cena, vuan nga sëmundja e rëndë, e cila ka nevojë për tretman të vazhdueshëm për shërim.

Shërimi i sëmundjes për të lartpërmendurin është tejet i kushtueshëm dhe i papërballueshëm për të, pasi asnjë anëtar i familjes nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme.

Andaj, duke marrë parasysh gjendjen e rëndë shëndetësore dhe financiare të të lartpërmendurit, pasi shpenzimet e mjekimit dhe të blerjes së barnave kanë kosto të lartë financiare, ai e ka të vështirë mbulimin e shpenzimeve elementare për jetesë dhe blerjen e barnave për shërimin e sëmundjes, kështu që është e domosdoshme ndihma për tejkalimin e kësaj gjendjeje.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me vendim të njoftohen:

- **Musa Cena nga Rahoveci,**
- **Drejtorja për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,**
- **Drejtorja për Buxhet dhe Financa, dhe**
- **Arkivi.**





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.4 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e **Adisa Zllanoga Vuqiterna** nga Rahoveci me Nr. Protokolit 06-553/01-0017055/25, e dt. 07.05.2025 për ndihmë financiare prej 500.00€ (pesëqind euro) për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Znj.Adisa Zllanoga Vuqiterna nga Rahoveci me datë 07.05.2025 ka parashtruar kërkesë për ndihmë financiare për lehoninë (lindje) pasi që me datë 28.04.2025 ka lindur **Vajz** në QKMF “Dr. Fahredin Hoti” në Rahovec.

Marrë parasysh se, e lartpërmendura nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme dhe me këtë rast e njëjta pas shpenzimeve të lindjes e ka të vështirë përballimin e shpenzimeve të blerjes së gjërave elementare për fëmijën, është e domosdoshme ndihma financiare për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë për **znj.Adisa Zllanoga Vuqiterna** si dhe ndihma për sigurimin e gjërave elementare për foshnjën.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

Me vendim të njoftohen:

- **Znj.Adisa Zllanoga Vuqiterna, nga Rahoveci,**
- **Drejtorja për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,**
- **Drejtorja për Buxhet dhe Financa, dhe**
- **Arkivi.**





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe propozimit të Përgjegjësit të Njësisë Kërkuese dhe Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: **"Furnizim me rekuizita për nevojat e Komunës së Rahovecit"**, me numër të kontratës: **623-25-2298-1-2-1/C669**, si në vijim:
 - 1.1. Z. Muharem Morina, i sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: Zyrtar për Kulturë, në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, **CAKTOHET** menaxher i kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2. Z. Afrim Dina, drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik, Rregulloren 01/2022 për Prokurimin Publik, Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhimin të Kontratës, si dhe të rregullave të tjera, të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e kontratës. Pas nënshkrimit të kontratës dhe të emërimit të Menaxherit të kontratës (MK), të gjitha përgjegjësitë, përveç kompetencës për të ndryshuar apo ndërprerë Kontratën, barten nga zyra e prokurimit të Menaxherit të Kontratës.
3. Përgjegjësitë e Menaxherit të Projektit/Kontratës janë:
 - 3.1. Menaxheri i kontratës do të menaxhojë obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuara në kontratë;
 - 3.2. Menaxheri i kontratës do të sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë; dhe
 - 3.3. Menaxheri i kontratës do të bëjë vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.
4. Funksonet e Menaxherit të Projektit/Kontratës, janë:
 - 4.1. Në pajtim me Kapitullin V të Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik, pas pranimit të Njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës, duhet të kyçet në

Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të fillojë me fazat e menaxhimit të Kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë, Menaxheri i kontratës brenda afatit, duhet të krijojë Planin për Menaxhim të kontratës, duke përdorur funksionin "Fillimi / mobilizimi i kontratës";

- 4.2. Menaxheri i kontratës, duhet të lexojë kushtet e kontratës dhe të përgatisë Planin e Menaxhimit të kontratës (PMK), i cili duhet të bie dakord me Operatorin Ekonomik;
 - 4.3. Të dorëzojë Planin e aprovuar të Menaxhimit të Kontratës, kërkesën (fletëporosinë) dhe Zotimin e mjeteve në Zyrë të Prokurimit, në mënyrë që zyra e prokurimit të nxjerrë urdhërblertjen;
 - 4.4. Pas pranimit të urdhërblertjes nga zyra e prokurimit, menaxheri i kontratës duhet të vendosë të dhënat në platformën elektronike, të ngarkojë në platformën elektronike urdhërblertjen dhe ta përcjellë përmes platformës tek OE-ja, nga e cila datë fillon numërimi i afatit kohor për liferim;
 - 4.5. Të sigurojë që Operatori Ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës, apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.6. Të sigurojë që Operatori Ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.7. Të sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet e tjera, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.8. Të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, të cilësisë, dhe të kohës aty ku është e përshtatshme;
 - 4.9. Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;
 - 4.10. Të sigurojë që të gjithë regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, të mbahen dhe të arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës, në sistem të prokurimit elektronik;
 - 4.11. Të nxjerrë variacione apo urdhra për ndryshim, nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.12. Të sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit dhe ta marrë miratimin;
 - 4.13. Të menaxhojë dorëzimet e procedurave të pranimit të punëve, të mallrave dhe të shërbimeve;
 - 4.14. Të japë detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit; dhe
 - 4.15. Të dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit, ose nga ZKA-ja.
5. Përgjegjësitë e Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, janë:
- 5.1. Monitorimi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës; dhe
 - 5.2. Rishikimi, aprovimi dhe procesimi i vlerësimit të performancës së kontraktuesit – vlerësime të propozuara nga menaxherët e kontratave, nën mbikëqyrjen e tij.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- *Menaxheri i kontratës,*
- *Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,*
- *Spektori i Prokurimit, dhe*
- *Arkivi.*


Smajl Latifi
Kryetar i Komunës
Zyrtar Kryesor Administrativ



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 5763 Nr. i faq/Br.str/No.pg 79
Data/Datum/Date 8 / 5 / 2025
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 53 paragrafit 3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 88 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, nenit 18 paragrafi 3 i Rregullores (QRK) Nr. 11.2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me nr. prot. 02/3707 të datës 5.1.2024, për caktimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave për nëpunësit e shërbimit publik

1. Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi me nr. prot. 02/3707 i datës 5.1.2024, për caktimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave për nëpunësit e shërbimit publik.
2. Pika 1.2. e vendimit bazik ndryshohet dhe plotësohet, si në vijim:
1.2. Egzon Thaqi, anëtar.
3. Pikët e tjera të vendimit bazik me nr. prot. 02/3707 të datës 5.1.2024, mbesin të pandryshuara.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Me vendimin me nr. prot. 02/3707 të datës 5.1.2024 është caktuar komisioni për shqyrtimin e ankesave për nëpunësit e shërbimit publik.

Duke marrë parasysh se Jeton Krasniqi, i cili me vendimin bazik ishte caktuar anëtar, nuk mund të jetë pjesë e këtij komisioni, është i domosdoshëm zëvendësimi i tij dhe caktimi i Egzon Thaqit anëtar nga Drejtoria për Arsim.

Andaj, nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- Egzon Thaqit,
- Arsım Kastratit – kryesues i komisionit,
- Njesisë së Personelit, dhe
- Arkivit.

Shtajl Latifi
Kryetar i Komunës